

Ligji Nr. 111/2016 dt. 03.11.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993,
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË R.SH.”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në R.Sh.”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në **nenin 84**, pika 2 ndryshohet me si më poshtë:

“2. Kërkesat, së bashku me dokumentet e përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paraqiten dhe administrohen në sportelet e shërbimit, në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.”.

Neni 2

Në **nenin 86**, pika 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ankimi, në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.”.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I
Ilir META**

Miratuar në datën 3.11.2016

Botuar ne F.Zyrtare 219/2016
Dale nga shtypi me 15.11.2016